

VENDIM
N.678, datë 4.10.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.289, DATË 17.5.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT
DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE (ALUIZNI)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 46 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.289, datë 17.5.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Shkronjat “a”, “b” e “c” të pikës 5, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a) Drejtorinë e legalizimit, të kompensimit dhe urbanizimit, përgjegjëse për zbatimin teknik të procesit të legalizimit, përfshi procesin e kompensimit të pronave private, që preken nga ky ligj, si dhe procesin e urbanizimit të ndërtimeve pa leje në vendbanimet informale, zonat informale dhe në territore të tjera.

b) Drejtorinë e hartografisë, teknologjisë së informacionit dhe regjistrimit fillestar të ndërtimeve pa leje, përgjegjëse për përgatitjen e bazës materiale hartografike, të nevojshme, për zbatimin e teknologjisë së informacionit, në funksion të krijimit dhe administrimit të bazës së të dhënave, për evidentimin dhe përgatitjen e dokumentacionit, si dhe unifikimin e procedurave përkatëse, për regjistrimin e truallit dhe të ndërtimit pa leje.

c) Drejtorinë e burimeve njerëzore, të çështjeve juridike dhe shërbimeve mbështetëse, në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë së ALUIZNI-t.”.

2. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Personeli i ALUIZNI-t duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme, të përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil, dhe kërkesat e veçanta, që përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm i kësaj agjencie. Marrëdhëniet e punës rregullohen me ligjin nr.7971, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.”.

3. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të kësaj agjencie.”.

4. Pika 15 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“15. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, prefektët dhe Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha